



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K2/P16-5 Prot.
Nr. Dok. 202401189/5

Tiranë 02/05/2025

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave për respektimin e të drejtës për informim të palëve në proces si dhe vënien në dispozicion të Institucionit të Avokatit të Popullit të informacionit lidhur me veprimet hetimore të kryera nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për procedimin penal nr.3283/2023.

PROKURORISË SË PËRGJITHSHME

**PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË**

Për dijeni: KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Të nderuar,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur një ankesë shtetësja **P. R.** me banim në Rrugën "Hamdi Pepo" nd.1, hyrja 1, Tiranë. Në ankesën e saj me shkrim, qytetarja shprehet se ka paraqitur një kallëzim penal në datën 30.04.2023 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, lidhur me vdekjen e djalit të saj J.(Edison) R., i cili ishte i ndaluar në Bllokun e Dhomave të Sigurisë, DVP-së Tiranë. Në bazë të këtij kallëzimi, organi i prokurorisë ka regjistruar procedimin penal nr. 3283 dhe prokuror i çështjes ishte Z. A. Demirneli.

Ankuesja shprehet se i është drejtuar disa herë organit të prokurorisë për të marrë informacion lidhur me veprimet hetimore të kryera për këtë çështje, si dhe kopje të akteve, si procesverbale, akt-ekspertimi, etj. Por, ndonëse **kanë kaluar me shumë se 1 (një) vit e gjysëm**, ankuesja nuk ka asnjë informacion përveç faktit se në dy përgjigjet e marra nga organi i prokurorisë, shprehet se: *“procedimi penal është në fazën e hetimeve paraprake dhe në përfundim të tyre do të njiheni me aktet”*.

Gjithashtu në ankesën e saj ajo ngre dhe pretendimin lidhur me mosrespektimin e afateve të hetimit. Ndonëse kanë kaluar afatet e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale për periudhën e hetimit, ankuesja në cilësinë e trashëgimtares së viktimës, nuk ka marrë asnjë njoftim lidhur me vendimin e prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve.

Ankuesja shprehet gjithashtu se, i është drejtuar disa herë organit të prokurorisë për të marrë informacion lidhur me veprimet hetimore të kryera për këtë çështje, por ajo nuk ka marrë asnjë informacion tjetër përveç faktit se, kjo çështje i ka kaluar prokurores **E. P.**

Humbja e jetës së një shtetasi në vendin e vuajtjes së dënimit është një ngjarje sa sensitive për opinionin publik, për besimin ndaj strukturave shtetërore, por për më tepër për familjarët e viktimës, e cila nuk mund dhe as duhet të anashkalohet në rutinën e veprimtarisë së përditshme apo në justifikimet e mungesës së prokurorit apo burokracive të tjera administrative, por kërkon një reagim dhe ndërveprim të shpejtë dhe efektiv.

Në këto kushte, në vlerësimin dhe gjykimin e Avokatit të Popullit, nuk ka asnjë pengesë ligjore dhe procedurale për vijimin e veprimeve dhe hetimin e procedimit penal nr. 3283/2023, me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve dhe vendimet respektive, duke informuar edhe familjarët e shtetasit të ndjerë. Ata përpos dhimbjes për humbjen e njeriut të tyre, kërkojnë nga drejtësia shqiptare të bëhen verifikimet e nevojshme në lidhje me faktin nëse i afërmi i tyre është vetëvrarë apo ka humbur jetën si pasojë e dhunës së ushtruar nga personeli i burgut apo kushdo tjetër ku ka qenë i izoluar, apo neglizhenca në dhënien e ndihmës mjeksore. Mbetet e pajustificuar mungesa e informacionit përtej çdo afati të arsyeshëm për më shumë se një vit, lidhur me veprimet hetimore dhe ecurinë e hetimeve për këtë rast.

Në këto kushte, Znj. P.R. iu drejtua institucionit të Avokatit të Popullit, i cili ka në misionin e tij mbrojtjen dhe promovimin e respektimit të të drejtave themelore të njeriut nga administrata publike, duke kërkuar ndërhyrjen pranë organit tuaj për dhënien e informacionit të kërkuar.

Pasi u njohëm me ankesën, referuar nenit 13, paragrafi i parë, i ligjit nr.8485, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *“Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur*

një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”, vlerësuam se ajo përmban elemente për t’u pranuar për shqyrtim nga ana e institucionit tonë.

Në kuadër të verifikimit dhe shqyrtimit të kësaj ankese, institucioni ynë u drejtua institucionit tuaj me shkresën Nr. K2/P16-3 prot., datë 18.09.2024, ku kërkuam të informohemi se çfarë veprimesh procedurale ishin kryer deri në atë moment lidhur me këtë kallëzim penal.

Organi i prokurorisë **nuk** ka kthyer përgjigje kërkesës tonë dhe në këto kushte ne iu drejtua përsëri me shkresën nr. K2/P16-4 datë 19.12.2024 “Kërkesë e përsëritur për informacion”, por ende dhe sot nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, **nuk** kemi asnjë përgjigje.

Bazuar në pikën 4 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij, në nenin 14 të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar ku parashikohet se: “Avokati i Popullit mund të mos fillojë ose ndërpret hetimin në qoftë se e njëjta çështje është vendosur ose është në shqyrtim nga prokuroria apo gjykata. Në këto raste, ai ka të drejtë të kërkojë informacion pranë këtyre organeve, të cilat duhet t’u përgjigjen kërkesave të tij sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 ditë”, si dhe në nenin 20 ku parashikohet gjithashtu se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë edhe informacione apo dokumente, që lidhen me çështjen në shqyrtim, të klasifikuara si sekret shtetëror. Në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e sekretit shtetëror”, organi i prokurorisë është i detyruar të na përcielli informacionin e kërkuar.*

Gjithashtu, mungesa e informacionit ndaj trashëgimtarit të viktimës dhe ndaj Avokatit të Popullit, bie në kundërshtim dhe me Udhëzimin nr.5 datë 30.07.2019 “*Për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm*” të Prokurorit të Përgjithshëm¹.

Në këtë udhëzim Kapitulli III dhe IV udhëzon prokurorët se si të balancojnë të drejtën e informimit dhe ruajtjen e sekretit hetimor, por në çdo rast nuk e ndalon dhënien e informacionit. Në rastin kur prokurori gjykon se duhet të ruhet sekreti hetimor në fazën e hetimeve paraprake, ai urdhëron personin që ka marrë informacion të ruajnë sekretin dhe mos të publikojë dhe të shpërndajë informacionin dhe këtë e shoqëron dhe me një deklaratë për ruajtjen e sekretit, mos publikimin, e cila nënshkruahet nga palët.

Prokurori, sipas legjislacionit shqiptar, është një funksionar publik që përfaqëson interesat e shtetit në çështjet penale dhe ka për detyrë kryesore ndjekjen penale të veprave penale,

¹ Udhëzimi nr.5 datë 30.07.2019 i Prokurorit të Përgjithshëm, neni 9 “Detyrimi për të mbrojtur sekretin hetimor”.

hetimin dhe përgatitjen e akuzave kundër personave që dyshohen për kryerjen e këtyre veprave. Në këto kushte ai si çdo funksionar tjetër publik duhet të respektojë legjislacionin cituar më lartë në raport me informacionin dhe hetimin që Avokati i Popullit mund të kryej pranë çdo institucioni apo funksionari publik në përputhje me mandatin e tij.

Sa më sipër, vihet re një qasje e mbyllur e organit të prokurorisë, si dhe një klimë paragjyquese dhe penguese ndaj Institucionit të Avokatit të Popullit për ushtrimin e detyrës së tij kushtetuese, e cila synon mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut nga veprimet apo mosveprimet e funksionarëve publik.

Nëse do t'i referohemi Kodit të Procedures Penale, konkretisht:

Neni 58

Të drejtat e viktimës së veprës penale

gërma d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor.

Neni 105

Marrja e kopjeve, ekstrakteve dhe vërtetimeve

(Shtuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

- 1. Gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cilido që ka interes mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta apo të regjistrimeve audio ose audiovizive.*
- 2. Kërkesa shqyrtohet nga prokurori, për aktet e hetimit paraprak, ose nga gjykata që ka dhënë vendimin për ato të shqyrtimit gjyqësor.*
- 3. Lëshimi i kopjeve, ekstrakteve ose vërtetimeve nuk e heq ndalimin e publikimit*

Neni 110

Memoriet dhe kërkesat e palëve

- 1. Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim.*
- 2. Organi procedues shprehet me vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve.*

Në rastin e viktimës (trashëgimtarit të viktimës), dhe jo vetëm atij, por dhe të pandehurit apo personit nën hetim (pra pesonat që janë palë në një proces penal), **është detyrë dhe jo e drejtë e organit procedues** të njohë dhe të informojë të gjithë këto subjekte me veprimet hetimore apo provat materiale të cilat kanë shërbyer për ngritjen e akuzës dhe ky standard, është i detyrueshëm dhe nuk mbetet në diskrecionin e tij personal².

² Neni 58, K.Pr.P. “Të drejtat e viktimës së veprës penale” dhe Neni34/a K.Pr.P. Të drejtat e të pandehurit

Duke analizuar në tërësi parashikimet në K.Pr.P. për sa i përket të drejtës së informimit në një proces penal, vëmë re se ligjvënësi ka patur parasysh se viktimë, i pandehuri dhe personi nën hetim, kanë një pozitë juridike të veçantë në krahasim me subjektet e tjera duke përcaktuar qartazi se e drejta e tyre për informim lidhur me një proces penal ku ata janë palë, ndaj kjo e drejtë duhet t'u garantohet në mënyrë të detyrueshme.

Ndërkohë që, për palë të tjera të interesuara siç mund të jenë, media, organizata jo qeveritare për arsye raportimi apo të dhënash statistikore në veprimtarinë e tyre, dëshmitari në një proces penal, etj, këtë të drejtë ligjvënësi e ka kushtëzuar me vendmarrjen e prokurorit³.

E drejta për një proces të rregullt ligjor është një e drejtë kushtetuese, e cila e vendos organin procedues para një sërë detyrimesh, duke filluar nga vënia në dijeni e individit për shkakun e akuzës së ngritur ndaj tij, respektimin e të drejtave procedurale dhe zhvillimin e hetimit dhe gjykimit brenda një “afati të arsyeshëm”, pa lejuar zvarritje të papërligjura dhe arbitrare të organit procedues. Shpejtimi i procedurave të hetimit dhe gjykimit është i lidhur drejtpërsëdrejti me të drejtat dhe liritë themelore nga njëra anë, dhe detyrimin për realizimin e një hetimi të gjykimit objektiv, të plotë, të saktë e të shpejtë nga ana tjetër. Mohimi i të drejtës për informim, mosdhënia e akteve apo mosshqyrtim i kërkesave të palëve në procesin penal, është me pasoja në zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

Në ndryshimet e fundit legjislative në të drejtën penale, i është kushtuar një vëmendje e shtuar viktimës së veprës penale. Viktima në një proces penal ka një pozicion të rëndësishëm dhe disa të drejta që sigurojnë mbrojtjen dhe përfaqësimin e saj gjatë procedurës penale. Viktima, në kontekstin e një vepre penale, është personi që ka pësuar dëme, qoftë materiale, qoftë fizike, psikologjike apo emocionale, si rezultat i veprës penale. Në rastin kur viktimë e një vepre penale ka humbur jetën, atëherë trashëgimtarët e tij ligjorë si palë në proces duhet të kenë dhe gëzojnë të gjitha të drejtat për t'u informuar dhe njohur me ecurinë e hetimeve. Trashëgimtari i viktimës mund të marrë pjesë aktivisht në procesin penal, duke paraqitur kërkesa, duke marrë pjesë në seanca gjyqësore dhe duke ushtruar të drejtat e saj procedurale.

Pozicioni i viktimës në procesin penal është i rëndësishëm për të siguruar që ajo të marrë drejtësi dhe të ndihmohet në përballimin e pasojave të veprës penale. Ligjet shqiptare synojnë të garantojnë që viktimat të trajtohen me respekt dhe të kenë qasje të plotë në drejtësi.

³ Neni 105 K.Pr.P. “Marrja e kopjeve, ekstrakteve dhe vërtetimeve”.

Nëse organi i prokurorisë do të përcillte një informacion lidhur me veprimet hetimore të ndërmarra deri në momentin kur iu kërkua, si nga ankuesi (trashëgimtari i viktimës në këtë rast) dhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit, jo vetëm që do të respektonte një të drejtë që këto dy subjekte e gëzojnë me ligj, por do të ndihmonte dhe në sqarimin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm të pretendimeve të ankuesit lidhur me veprimet procedurale ose (mungesen e tyre) nga ana e prokurorit.

Sekreti hetimor dhe e drejta e viktimës për informim gjatë fazës së hetimeve paraprake janë dy aspekte të rëndësishme të procesit penal. Këto dy elemente balancojnë interesat e hetimit me të drejtat e viktimës për t'u informuar.

Ligji synon të krijojë një balancë midis ruajtjes së sekretit hetimor dhe respektimit të të drejtave të viktimës. Kjo balancë është delikate dhe varet nga natyra e çështjes dhe rrethanat specifike. Në çdo rast, prokuroria dhe organet hetimore duhet të kujdesen që të

mos çënojnë hetimin, ndërsa njëkohësisht të respektojnë të drejtat themelore të viktimës për t'u informuar dhe për të marrë pjesë në procesin penal.

Pyetja shtrohet: A do të çënojnë hetimin nëse prokurori do të informonte viktimën apo Avokatin e Popullit në lidhje me veprimet procedurale që kishte kryer deri në atë moment, (informacion i përgjithshëm) duke ruajtur sekretin hetimor; si emrat e dëshmitarëve, personat nën hetim apo përgjim?

Në vlerësimin e Avokatit të Popullit, mungesa e dhënies së informacionit për një periudhë më shumë se 1 (një) vit përveç se çënon të drejtën e viktimës për informim, do të çonte në një perceptim që organi i prokurorisë nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim hetimor deri në atë moment.

Sekreti hetimor është një parim i rëndësishëm në procedurën penale shqiptare që synon të ruajë konfidencialitetin e hetimeve gjatë fazës paraprake me qëllim thelbësor të zbulimit të ekzistencës së faktit penal dhe përgjegjësit për kryerjen e tij nga ana tjetër. Ky parim ekziston për të mbrojtur integritetin e hetimit, për të shmangur ndërhyrjet e jashtme, dhe për të siguruar që provat të mblidhen në mënyrë të papenguar. **Prokuroria** dhe organet hetimore janë përgjegjëse për zbatimin efektiv dhe permbytësor të konceptit të sekretit hetimor dhe për mbajtjen konfidenciale të informacionit që mund të dëmtojë ecurinë e hetimit ose të shkaktojë paragjykim.

Fakti që legjislacioni penal nuk ka një përkufizim eksplisit se çfarë konsiderohet sekret hetimor, do të thotë që e ka lënë në kompetencë të organit të prokurorisë që në vlerësim të çështjes dhe rrethanave, të gjykojë dhe të vendosi se në cilat raste mund të çënohet sekreti hetimor, gjithashtu prokurori mund ta bëjë me dije subjektin që disponon një

informacion, për përgjegjësinë penale në rast të shpërndarjes apo publikimit të informacionit konfidencial pa leje.⁴

Për të ruajtur këtë balancë midis sekretit hetimor dhe të drejtës së viktimës për informim, organi i prokurorisë duhet të respektojë të drejta të caktuara për informim gjatë fazës së hetimeve paraprase për viktimën si;

1. **E drejta për informacion të përgjithshëm:** Viktima ka të drejtë të informohet për statusin e çështjes së saj dhe për ecurinë e hetimeve në mënyrë të përgjithshme, pa cënuar sekretin hetimor. Kjo përfshin informacione si regjistrimi i denoncimit, emrat e të pandehurve (kur nuk pengon hetimin), dhe kohën kur pritet të përfundojë hetimi.
2. **E drejta për të marrë informacion mbi vendimet që prekin drejtpërdrejt viktimën:** Për shembull, nëse prokurori vendos të mbyllë hetimet ose të pushojë çështjen, viktima ka të drejtë të informohet për këtë dhe të kërkojë rishqyrtim të vendimit ose të bëjë ankim në gjykatë.
3. **E drejta për të kërkuar akses në dosjen hetimore:** Viktima mund të kërkojë akses në dosjen hetimore, por ky akses mund të kufizohet nëse ai rrezikon të dëmtojë hetimin ose sigurinë e dëshmitarëve. Prokurori mund të vendosë të kufizojë qasjen në dokumente të caktuara për të mbrojtur sekretin hetimor.
4. **E drejta për të qenë e informuar për lirimin e të pandehurit:** Në raste kur i pandehuri lirohet nga paraburgimi, viktima ka të drejtë të informohet menjëherë për këtë fakt, sidomos nëse ekziston një rrezik për sigurinë e saj.

Në Kodin e Procedurës Penale, disa nene rregullojnë konfidencialitetin e hetimeve dhe sekretin hetimor, si psh neni 103 i K.Pr.P. "Ruajtja e sekretit të hetimit"⁵ i cili përcakton që aktet e hetimit paraprase duhet të mbahen sekrete dhe të mos bëhen publike deri në përfundimin e hetimit, si dhe neni 104 i K.Pr.P. "Shkelja e ndalimit të publikimit"⁶ i cili specifikon se cilat akte mbahen të fshehta dhe rregullat për mbajtjen e tyre nga personat që kanë qasje në to.

Këto nene janë kyçe për të kuptuar se si trajtohet sekreti hetimor dhe konfidencialiteti në hetimet paraprase në legjislacionin penal si dhe respektimi i të drejtës së informimit në këtë fazë të hetimit. Në lexim dhe interpretim të këtyre dispozitave në veçanti por dhe në frymën në tërësi të legjislacionit përsa i përket kufirit midis së drejtës së informimit dhe sekretit hetimorë, kuptojmë qartë se ligji asnjëherë nuk e ndalon informimin në fazën e

⁴Neni 8 dhe Neni 9 i Udhëzimit nr.05. datë 30.07.2019 i Prokurorit të Përgjithshëm.

⁵ Neni 103, K.Pr. Penale "Ndalimi i publikimit të akteve"

1. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv.

2. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprase.

⁶ Neni 104 i K.Pr.P. "Shkelja e ndalimit të publikimit"

Shkelja e ndalimit të publikimit e bërë nga nëpunësi i shtetit ose i një enti publik, kur nuk përbën veprë penale, është shkelje disiplinore. Në këtë rast prokurori njofton organin që ka të drejtë të marrë masa disiplinore.

hetimeve paraprake. Prokurori i çështjes duke analizuar nëndarjet e të drejtës së informimit si cituam më lartë në fq 6, mund të arsyetojë se pse disa të dhëna përbëjnë sekret hetimor dhe nuk mund t'i informojë palët në proces apo dhe Avokatin e Popullit për ndonjë informacion që ai gjykon shumë të rëndësishëm dhe kofidencial për hetimin paraprak.

Avokati i Popullit në zbatim të Kushtetutës dhe kuadrit ligjor aktual vlerëson dhe respekton pavarësinë e prokurorit në drejtim të cilësisë dhe veprimeve procedural në hetim, vendimarrjes dhe përfaqësimit të akuzës publike në gjyq, por përse i përket funksionimit të organit të prokurorisë dhe prokurorit në veçanti në raport me respektimin e të drejtave të qytetarëve, Avokati i Popullit është një institucion kushtetues i cili ka të drejtë të monitorojë edhe pushtetin gjyqësor në lidhje me administrimin e rasteve dhe rekomandojë lidhur me gjetjet. Kufizimi lidhet vetëm me thelbin e vendimarrjes e jo me faktin që prokurori po realizon apo jo detyrën e tij të përgjithshme për hetimin e çështjes dhe garantimin e të drejtave të palëve në këtë proces. Avokati i Popullit në punën e tij mëton që të monitorojë e garantojë se çështjet penale hetohen në përputhje me ligjin duke mos u cënuar afatet dhe e drejta e shtetasve për proces të rregullt ligjor. Sekreti hetimor nuk mund të përdoret si mburojë për të justifikuar mungesën e hetimeve për çështjet penale.

Çështjet në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë kanë interes publik të shtuar dhe në këtë aspekt organi i prokurorisë si një hallkë e rëndësishme e sistemit gjyqësor ka detyrimin për të kontribuar në administrimin dhe funksionimin e duhur të drejtësisë. Krijimi i një organi të pavarur dhe të paanshëm të ndjekjes penale është një nga parimet bazë të një sistemi drejtësie eficient. Reforma në drejtësi një nga qëllimet kryesore kishte pikërisht të garantonte pavarësinë e prokurorit por nga ana tjetër të krijonte dhe mekanizma të cilët kontrollojnë mirëfunksionimin e veprimtarisë së prokurorisë si dhe rritjen e transparencës ndaj publikut.

Cënimi i besimit të publikut ndaj sistemit të drejtësisë ishte dhe pikënisja kryesore e Reformës në Drejtësi të vitit 2016.

Kuadri i ri ligjor garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit të funksionit të tyre kushtetues dhe ligjor, si dhe kontrollin në ushtrimin e funksionit të tyre për të shmangur çdo sjellje që bie ndesh me funksionin e prokurorit apo që cënon mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë.

Parimet e Venecias e kanë përcaktuar qartazi se deri ku shtrihen të drejtat e Avokatit të Popullit lidhur me kontrollin mbi veprimet administrative të sistemit gjyqësor, e konkretisht në pikën 13 paragrafi 3, shprehet se: “*Kompetenca e Avokatit të Popullit në*

lidhje me gjyqësorin do të kufizohet në sigurimin e efikasitetit procedural dhe funksionimit administrativ të atij sistemi.”⁷

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon Prokurorinë si një organ kushtetues me funksion të pavarur⁸, pa e përfshirë atë konkretisht në ndonjërin nga pushtetet, por që është e organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor. Pavarësia e këtij organi parashikohet edhe në nenin 25, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale⁹. Kushtetuta rregullon në vija të përgjithshme funksionin dhe organizimin e prokurorisë në një pjesë të veçantë të saj. Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq, në emër të shtetit. Një sërë detyrash të tjera i caktohen organit të prokurorisë me ligj të posaçëm siç është Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Parimi i Shtetit të së Drejtës është i lidhur ngushtë me mirëfunksionimin e pavarur të pushtetit gjyqësor.

Ndërkohë, parimi i shtetit të së drejtës në lidhje me atë të ndarjes së pushteteve, nënkupton garantimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut.

Jurisprudenca e Gjykatës sonë Kushtetuese, në lidhje me zbatimin e parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, si dhe të parimit të shtetit të së drejtës, ka theksuar se pavarësia e gjyqësorit duhet kuptuar në disa aspekte. Në radhë të parë, duhet kuptuar si pavarësi thelbësore, pra një tagër e gjykatave për të dhënë vendime me paanësi dhe pa u ndikuar nga interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit; në radhë të dytë, si pavarësi strukturore, që kërkon parashikimin në Kushtetutë të institucionit që realizon emërimet dhe shkarkimet e gjyqtarëve; në radhë të tretë, si pavarësi organizative dhe financiare, e cila në vetvete përbën një pjesë të pavarësisë strukturore.¹⁰

⁷ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)005-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)005-e)

⁸ Neni 148 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se:

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.
2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.
3. Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.
4. Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme.

⁹ Neni 25

1. Funksionet e prokurorit ushtrohen:

- a) në hetimet paraprake dhe në gjykimet e shkallës së parë, nga prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë;
- b) në gjykimet e çështjeve të ankimuar, nga prokurorët pranë gjykatave të apelit dhe pranë Gjykatës së Lartë.

2. Në ushtrimin e funksioneve të tij prokurori është i pavarur. Rregullat për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga prokurori parashikohen në ligj.

3. Për veprat penale të parashikuara nga neni 75/a, i këtij Kodi, funksionet, sipas nenit 24, të tij, ushtrohen në të gjitha shkallët e gjykimit nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme.

¹⁰ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të RSH-së, Nr. 25, Viti 2008

Pavarësia e prokurorëve dhe e gjyqtarëve nuk presupozon që ata të mos mbajnë përgjegjësi në kryerjen e funksioneve të tyre. Kështu, ata janë të përgjegjshëm penalisht nëse kryejnë një vepër penale gjatë kryerjes së detyrës.

Kur nuk është fjala për vepra penale, ata i nënshtrohen procedimit disiplinor nga organet kompetente. Gjithashtu, ata nuk janë të përjashtuar as nga përgjegjësia civile në rrethana mjaft të përcaktuara, në kushtet kur qytetari që është dëmtuar financiarisht nga një qëndrim i fajshëm i prokurorit apo gjyqtarit, mund të kërkojë dëmshpërblimin e dëmeve nga këto subjekte të posaçëm. Në rastin e konstatimeve të mangësive të veprimeve hetimore në kuptim të përshtatshmërisë, shpejtësisë dhe kujdesit të nevojshëm për të bërë të mundur që autorët e veprës penale mos t'i shmangen drejtësisë, organet kompetente mund të marrin masa disiplinore ndaj tyre.

Togfjalëshi në nenin 145/2 të Kushtetutës (për gjyqtarët) se ... *“u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”*, ai në nenin 148/2 të Kushtetutës (për prokurorët) ... *“garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit”* dhe ai në nenin 25/2 të K.Pr.Penale *“Rregullat për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga prokurori parashikohen në ligj”*, nuk lënë asnjë hapësirë për diskutim lidhur me faktin e pavarësisë së organeve të prokurorisë ashtu edhe të gjykatës. Këto organe janë të detyruara që t'u nënshtrohen e të zbatojnë me korrektësi, objektivitet dhe paanësi Kushtetutën dhe ligjin, pasi këtu mbaron pavarësia e tyre. Në këtë kuptim, përgjegjësia e tyre për zbatimin e Kushtetutës dhe ligjit përbën edhe kufijtë e pavarësisë së tyre.

Neni 7 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon, se sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë *“bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”*.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj në disa vendime, duke iu referuar nenit 7 të Kushtetutës ka theksuar se ky parim, në demokraci, si formë e qeverisjes, *synon kryesisht të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi apo të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij.*

Sipas Gjykatës Kushtetuese, *parimi i ndarjes së pushteteve nuk duhet kuptuar që çdo pushtet është i mbyllur dhe i pakontrolluar nga askush. Ndarja e pushteteve midis tri degëve të qeverisjes garantohet vetëm nëpërmjet sistemit të kontroleve dhe ekuilibrave. Në këtë mënyrë, sipas Kushtetutës, aq sa flitet për ndarje bëhet fjalë edhe për ekuilibër të pushteteve. Qëllimi i një koncepti të tillë kushtetues siguron që të parandalojë çdo degë të qeverisjes për të ushtruar një pushtet të pakufizuar. Kontrollat dhe ekuilibrat që njeh Kushtetuta, i japin secilës degë, pushtete që kompensojnë apo zbusin ato të degëve të tjera. Ekzistojnë mjete apo mekanizma që balancojnë pushtetet, sepse në analizë të fundit asnjë*

pushtet në vete nuk është në gjendje të përmbushë misionin, nëse veprimtaria e tij nuk harmonizohet me veprimtarinë e pushteteve të tjerë dhe nëse nuk sigurohet një ekuilibër, bashkërendim dhe kontroll reciprok që natyrisht nuk ndërhyjnë në atë masë sa të dëmtojnë misionet e tyre kushtetuese”¹¹.

Sjellim në vëmendje se në nenin 31¹² të ligjit organik të Avokatit të Popullit, janë parashikuar 5 seksionet e Zyrës së Avokatit të Popullit dhe fusha e veprimtarisë së tyre. Njëri prej këtyre seksioneve është edhe ai për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura **dhe pushtetin gjyqësor.**

Ndërsa në nenin 25¹³ të këtij ligji “Personat dhe aktet jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit”, në paragrafin e fundit parashikohet se, Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, **që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore.** Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit **nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit.**

Pra, referuar këtyre parashikimeve ligjore, rezulton se Avokati i Popullit ka mandat edhe ndaj pushtetit gjyqësor dhe se pranimi e hetimi i ankesave, kërkesave ose njoftimeve për shkelje të të drejtave të njeriut, nuk prekin pavarësinë e gjykatës apo organit të prokurorisë në marrjen e vendimeve, por i referohen në mënyrë specifike respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Gjatë këtij viti kalendarik kemi patur disa ankesa, të cilat objekt të tyre kanë patur mosdhënien e akteve apo mosshqyrtimin e kërkesave të palëve në procesin penal lidhur me pretendime të ndryshme si për akuzën, pyetjen e dëshmitarëve, kryerjen e

¹¹ Vendimet nr. 11, datë 27.05.2004 dhe nr. 5, datë 05.02.2014i G.J.K.

¹² Në nenin 31 parashikohet se:

“Zyra e Avokatit të Popullit ndahet në pesë seksione të specializuara, në krye të të cilave vendosen komisionerët.

Këto seksione janë:

1. Seksioni për organet e administrates qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.
2. Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor.
3. Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues.
4. Seksioni për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.
5. Seksioni i përgjithshëm”.

¹³ Në nenin 25 parashikohet se:

Janë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit personat dhe aktet e mëposhtme :

a. Presidenti i Republikës

b. Kryetari i Këshillit të Ministrave

Gjithashtu, janë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit:

b. Urdhërat me karakter ushtarak të Forcave të Armatosura.

Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit.

ekspertimeve etj. Mosrespektimi i të drejtave të palëve në proces si dhe i të drejtës së informimit në veçanti, është me pasoja për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, dhe në jo pak raste qytetarit i humbet mundësia për t'iu vënë në vend e drejta e cënuar, pasi veprat penale janë parashkruar.

Zvarritja e procesit hetimor si dhe mungesa e informacionit nga ana e organit të prokurorisë cënon dhe besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë, ku të gjithë ne jemi të ndërgjegjshëm që një nga qëllimet kryesore të Reformës në Drejtësi të vitit 2016, ishte rritja e besimit të publikut tek Drejtësia.

Avokati i Popullit ka adresuar këtë problematikë dhe në rekomandimet e tij më herët¹⁴ si dhe në rekomandimin e vitit 2024.¹⁵

Kërkesat për informacion dhe shqyrtimi i tyre nga ana e Avokatit të Popullit nuk përfshijnë vlerësimin e përmbajtjes së veprimeve procedurale gjatë fazës së hetimeve paraprake nga ana e prokurorit, si dhe nuk çenojnë sekretin hetimor pasi ka dijeni të plotë për përgjegjësinë ligjore për ta ruajtur atë. Avokati i Popullit vlerëson se të drejtat e njeriut, janë e duhet të mbeten në qendër të çdo veprimtarie shtetërore përfshirë këtu dhe atë të organit të prokurorisë.

Kërkohe më tepër transparencë në komunikimin me kallëzuesin dhe palët në procesin penal, për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimeve penale dhe më tej për ecurinë e hetimeve apo mënyrën e përfundimit të tyre.

Në trajtimin e ankesës së qytetarit ndaj organit të prokurorisë, kemi mbajtur parasysh misionin e Avokatit të Popullit, si një institucion i pavarur kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të shtetasve edhe në procesin penal. Kjo për faktin se organi procedues i cili ngre një akuzë në emër të shtetit në procesin penal, me veprimet ose mosveprimet e tij gjatë ushtrimit të detyrës mund të çënojë të drejtat dhe liritë e qytetarëve gjatë këtij procesi.

Zvarritja e proceseve gjyqësore përfshirë këtu dhe fazën e hetimit paraprak me muaj e madje me vite të tërë, ka cënuar të drejtën për akses në drejtësi dhe drejtësinë pa vonesa. Miratimi i reformës në drejtësi dhe zbatimi i saj duhet të garantojnë qëllimin dhe të përmbushin nevojat e shoqërisë tonë për funksionimin e shtetit të së drejtës, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Sjellim në vëmendje edhe qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në jurisprudencën e saj, e cila në disa vendime ka theksuar se e drejta për një

¹⁴<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20drejtuar%20KLP-se%20dhe%20ILD-se.pdf>

¹⁵<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandimi%20p%C3%ABr%20respektimin%20e%20te%20drejt%C3%ABs%20p%C3%ABr%20informim%20dhe%20>

proces të rregullt ligjor, pjesë e të cilit është edhe garantimi i të drejtave të palëve në proces, ku përfshihet dhe e drejta për informim, garantohet nga neni 42 i Kushtetutës dhe se kjo e drejtë luan një rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.¹⁶

E drejta për një proces të rregullt ligjor është një e drejtë kushtetuese, e cila e vendos organin procedues para një sërë detyrimesh, duke filluar nga vënia në dijeni e individit për shkakun e akuzës së ngritur ndaj tij, respektimin e të drejtave procedurale përfshirë këtu dhe të drejtën për informim të palëve në proces dhe zhvillimin e hetimit dhe gjykimit brenda një “afati të arsyeshëm”, pa lejuar zvarritje të papërligjura dhe arbitrare të organit procedues. Shpejtimi i procedurave të hetimit dhe gjykimit është një element kyç në garantimin e të drejtave dhe lirive themelore. Zvarritja e paarsyeshme e procedurave cenon drejtësinë dhe e dëmton rëndësinë e procesit të rregullt ligjor. Proceset e ngadalta dhe arbitrare jo vetëm që rëndojnë palët e përfshira, por edhe komprometojnë integritetin e sistemit gjyqësor.

Gjithashtu nëse do t'i referohemi vendimeve më të fundit të Gjykatës Kushtetuese, ka një qëndrim lidhur me veprimet hetimore të paplota të organit të prokurorisë, afateve të tejzgjatura të hetimit. Në vendim ajo ka theksuar se nuk është respektuar parimi i subsidiaritetit, pra organi i prokurorisë nuk ka përmbushur funksionin kushtetues për të garantuar dhe mbrojtur të drejtën themelore të jetës.

Sipas Gjykatës Kushtetuese “Për shkak të mangësive të veprimeve hetimore në kuptim të përshtatshmërisë, shpejtësisë dhe kujdesit të nevojshëm, autorët e veprës penale mundën t'i shmangeshin drejtësisë. Mosidentifikimi dhe mosmarrja në kohë e të gjitha provave të nevojshme për zbardhjen e ngjarjes, ka çuar në kufizimin më pas të mundësive për zbulimin e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe të autorëve të saj. Ndonëse prokuroria dispononte disa të dhëna rreth personave të mundshëm të përfshirë në krim dhe për motivet e tij, ajo nuk rezulton të ketë ndjekur një linjë të qartë hetimi. Nëse veprimet hetimore do të kishin qenë të shpejta, të plota dhe të orientuara drejt, nisur nga kjo gjasë, rezultati i hetimit do të kishte qenë i ndryshëm, duke shmangur në këtë mënyrë situatën e pandëshkueshmërisë së autorëve të atyre ngjarjeve kriminale. Prokuroria nuk ka qenë e kujdesshme në kryerjen e një hetimi të plotë, të shpejtë dhe të gjithanshëm, në mënyrë që të siguronte zbatimin efektiv të ligjit për të siguruar mbrojtjen e së drejtës së jetës. Pezullimi i hetimit për zbulimin e autorëve për një periudhë të gjatë kohore (20 vjet) nuk ka ofruar asnjë përgjigje efektive në këtë drejtim.”¹⁷

Avokati i Popullit nga informacioni që disponon nuk del në konkluzion se në këtë rast kemi të bëjmë me cënim të së drejtës së jetës por e sjell si referencë këtë vendim në kuadër

¹⁶ Vendimi nr. 37, datë 05.11.2021; Vendimi nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese

¹⁷ vendimi nr. 42, datë 29.05.2024 i Gj.K. cenimi i së drejtës të jetës për shkak të moskryerjes së hetimeve të plota dhe efektive.

të nevojës për një qasje të balancuar dhe në vëmendje ndaj të drejtave që duhet të jenë në themel të punës së organeve të prokurorisë.

Sa më sipër e gjejmë të shprehur qartazi dhe në Preambulën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në referim të vendimeve të GJEDNJ¹⁸, por edhe praktikës së saj në përgjithësi “*case law*”, gjykatat përfshirë këtu dhe organin e prokurorisë vendase kanë detyrimin që të respektojnë parimin e rëndësishëm “*të përfundimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*”. Sa më sipër, si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, ky parim garanton mbrojtjen e të gjitha palëve të përfshira në procesin gjyqësor ndaj “*vonesave të tepruara procedurale*”, që në administrimin e drejtësisë rrezikojnë të drejtat e palëve dhe shtetin e së drejtës. Një drejtësi jo efikase dhe e vonuar çon në dëmtimin e besimit të qytetarëve tek institucionet e shtetit. Në çështjet gjyqësore, periudha e arsyeshme që merret në konsideratë për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor përfshin fazat që paraprijnë dhe pasojnë procesin gjyqësor, çka do të thotë sipas GJEDNJ-së, fillon që në momentin e hetimeve paraprake dhe ngritjes së akuzës dhe përfundon kur vendimi i arsyetuar merr formë të prerë dhe ekzekutohet.

Nga këndvështrimi i Avokatit të Popullit çmohet se shkelja e të drejtës për informim për palët në proces, mungesa e bashkëpunimit me institucionet e pavarura të cilat detyrë funksionale të tyre kanë mbikqyrjen dhe kontrollin e respektimit të të drejtave themelore të individit nga veprimet apo mosveprimet e administratës shtetërore përfshirë këtu dhe atë të sistemit gjyqësor, mosrespektimi i afateve procedurale, nevojitet të adresohen. Në këtë rast, konstatohet se është cënuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si dhe e drejta e informimit.

Rritja e besimit të publikut si një ndër qëllimet kryesore të reformës në drejtësi, do të realizohet pikërisht duke rritur më shumë transparencën dhe bashkëpunimin e organeve të sistemit të drejtësisë në raport me publikun, institucionet e pavarura dhe palët në proces.

Jo pa qëllim Avokati i Popullit i ka adresuar rekomandimet e tij lidhur me veprimtarinë e prokurorëve edhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Vlerësojmë se këto rekomandime përbëjnë një instrument të rëndësishëm për të ndihmuar Këshillin në kryerjen e një vlerësimi objektiv të përmbushjes së detyrave nga ana e prokurorëve, si dhe në identifikimin e mundshëm të shkeljeve etike, mangësive profesionale apo shkeljeve disiplinore.

Në ushtrimin e rolit të tij kushtetues si organ përgjegjës për garantimin e profesionalizmit, integritetit dhe llogaridhënies në sistemin e prokurorisë, Këshilli duhet të bashkëpunojë

¹⁸ PGV kundër Italisë, vendimi i GJEDNJ, datë 7.11.2000; **Çështja X kundër Francës, 1998**; Vocaturo kundër Italisë; Cappello kundër Italisë; Darvan kundër Turqisë, 2009; Zimmermann dhe Steinner kundër Zvicrës, datë 13.06.1983; Vendimi K.Klitshe de la Grande kundër Italisë, 27.10.1994; Poiss kundër Austrisë, datë 23.04.1097.

Vendimi “Hadjianastassiou kundër Greqisë, 16.12.1992

dhe të ndërveprojë në mënyrë aktive për të siguruar që prokurorët të veprojnë në përputhje me standardet më të larta të ligjshmërisë dhe paanësisë.

Për sa parashtruam më sipër, në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend dhe me qëllim rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura ankuesit, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, si dhe në nenin 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të informojë menjëherë Avokatin e Popullit lidhur me veprimet hetimore procedurale që janë kryer deri në këtë moment për procedimin penal nr.3283/2023, si dhe në çfarë faze ndodhet hetimi. Informacionit duhet të plotësojë qelimin e kompetencës së Avokatit të Popullit që lidhet me vlerësimin e faktit nëse prokurori i çështjes ka kryer veprimet hetimore për të realizuar hetimin sipas afateve procedurale dhe **jo në lidhje me përmbajtjen apo konkluzionet e tyre.**
2. Të informohet menjëherë shtetësja P. R., si trashëgimtare (*mamaja e viktimës*) e viktimës dhe si person i cila ka depozituar kallëzimin penal, lidhur me veprimet hetimore procedural që janë kryer deri në këtë moment për procedimin penal nr.3283/2023.
3. Të merren masa nga ana e organit të prokurorisë që në respektim të Kushtetutës, Kodit të Procedurës Penale, ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, Udhëzimit nr.5 dt.30.07.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm, të informojë palët në proces, palët e interesuara, publikun, lidhur me hetimin dhe ndjekjen penale.
4. Prokuroria e Përgjithshme të marrë masat e nevojshme për të kërkuar nga Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit dhe në veçanti Udhëzimit nr.5 dt.30.07.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm.

5. Të merren masa për sigurimin e një bashkëpunimi më të mirë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me institucionin e Avokatit të Popullit, duke rritur transparencën, shmangur burokracitë dhe vonesat e pajustificuara gjatë hetimeve administrative, për përcjelljen e informacionit të saktë dhe dokumenteve hetimore.

Lidhur me qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, duhet të në ktheni përgjigje brenda 30 ditëve në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, të ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

**Besnik DEDA
D.V.**